

AKT -THEMELIMI

i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “FitnessAcademy–Albania” sh.p.k.

Neni 1 – Themeluesi i Shoqërisë

Unë, i nënshkruari: **Marin Camaj** shtetas shqiptar, lindur më 10/10/1992 me nr. personal J21010080E, banues në Tiranë me adresë të përhershme në Rr. Idriz Dollaku, Pallat i Firmës Domus Sh.p.k, Apartamenti 19, në cilësinë e **Ortakut të vetëm** dhe njëkohësisht **Administrator**, vendosa të themeloj një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” - i ndryshuar.

Neni 2 – Emërtimi, Forma juridike

Emërtimi i Shoqërisë do të jetë **“FitnessAcademy-Albania”** Forma Juridike e saj është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.), me Ortak të vetëm Marin Camaj.

Neni 3 – Emri, selia dhe kohëzgjatja

1. Emri tregtar i shoqërisë është **“FitnessAcademy-Albania” sh.p.k.**
2. Selia e shoqërisë është: Rr. Idriz Dollaku, Pallat i Firmës Domus Sh.p.k, Apartamenti 19, Tiranë- Shqipëri. Adresa mund të ndryshohet me vendim të Administratorit dhe regjistrohet në QKB.
3. Shoqëria themelohet për një kohëzgjatje të pacaktuar. Si datë e fillimit të aktivitetit do të jetë data e regjistrimit në QKB

Neni 4 – Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Ofrimi i shërbimeve të fitness-it online dhe në palestër;

Shërbime dhe këshillime për mirëmbajtjen fizike dhe shëndetësore trupore;

Organizimi i programeve stërvitore, trajnimeve dhe eventeve sportive;



Importi, eksporti dhe tregtimi i pajisjeve të fitnesit, artikujve sportivë dhe produkteve ndihmëse;

Çdo aktivitet tjetër tregtar i lejuar me ligj dhe që lidhet me objektin e mësipërm.

Neni 5 – Kapitali fillestar dhe kuotat

1. Kapitali fillestar i shoqërisë është **100,000 (njëqind mijë) lekë**, i tëri i paguar nga ortaku i vetëm.
2. Kapitali përbëhet nga 1 kuotë e vetme me vlerë **100,000 lekë**.
3. Kuota e Kapitalit zotërohet nga ortaku i vetëm, Marin Camaj.

Neni 6 – Përfaqësimi

Shoqëria përfaqësohet ligjërisht nga **Administratori, i cili është Ortaku i Vetëm**. Ai ka të gjitha kompetencat e parashikuara me ligj dhe statut.

Neni 7 - Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 8 – Hyrja në fuqi

Ky Akt-Themelimi hyn në fuqi me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Data: 09/09//2025

Vendi: Tiranë

ORTAKU THEMELUES

Marin Camaj
